

THIRRJE PËR APLIKIM NË KUADËR TË FONDIT TË GRAVE TË KOSOVËS

Publikuar më: 6 shtator 2021

Afati i fundit për aplikim: 4 tetor 2021

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka kënaqësinë të publikojë raundin e 16-të të granteve në kuadër të Fondit të Grave të Kosovës (FGK), i cili, për herë të parë do të ofrojë "mbështetje organizative" për organizatat anëtare të RrGK-së. Ftojmë të gjitha organizatat anëtare të cilat kontribuojnë **në avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave dhe barazisë gjinore në Kosovë** që të dorëzojnë aplikacionet për këtë thirrje.

Çfarë është mbështetja organizative?¹

Mbështetja organizative (mbështetje e buxhetit të përgjithshëm, mbështetje thelbësore, ose financim i pakushtëzuar) nënkupton financimin fleksibil, dhënë një organizate për t'i mundësuar asaj që të realizojë planin dhe synimet e tyre të përgjithshme strategjike. Ky lloj i mbështetjes dallon nga financimi i ofruar përmes një projekti të veçantë, i cili duhet të përdoret vetëm për objektiva dhe aktivitete specifike (shpesh i njohur edhe si "financimi i kushtëzuar" sepse është "i kushtëzuar" me një aktivitet të caktuar dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera). Ekzistojnë disa përkufizime të shprehjes mbështetje organizative. Në parim, mbështetja organizative do të thotë mbështetje për realizimin e strategjisë së përgjithshme, shpenzimet operative dhe administrative të organizatës. Në vend që një organizatë të ndjekë procedurat e donatorëve, mbështetja organizative zakonisht i lejon organizatës të përdorë procedurat e veta për auditim, prokurorim dhe raportim. Në vend të përqendrimit të kostot, mbështetja organizative përqendrohet në rezultatet e arritura. Për më tepër, organizata (dhe jo donatori) vendos se cilat rezultatet do arrihen.

Kështu, mbështetja organizative kontribuon në çdo kosto që ka organizata, drejt realizimit të qëllimeve strategjike. Kjo mund të përfshijë, por jo domosdoshmërisht të kufizohet në:

- Shpenzimet e përgjithshme, administrative ose shpenzimet e përgjithshme organizative, përfshirë personelin;
- Zbatimin e planit strategjik të organizatës;
- Avokimin, ashtu siç përcaktohet nga vet organizata anëtare;
- Zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatës.

¹ Kjo pjesë dhe pjesët në vijim janë nxjerrë nga *Udhëzimet e Kvinna till Kvinna për Mbështetjen Institucionale*, të përshtatura bazuar në qëllimet strategjike të RrGK-së, përvojën dhe hulumtimet paraprake të bazuara në dëshmi mbi temën, përfshirë intervistat me anëtarët e RrGK-së.

Zbatuar nga:



Përse mbështetja organizative?²

Ka disa arsye përse RrGK beson se mbështetja organizative është e rëndësishme dhe përpiket t'ia ofrojë atë organizatave anëtare:

- **RrGK u beson aktivistëve:** Ne besojmë se aktivistët për të drejtat e grave i dinë më së miri nevojat e komuniteteve të tyre, prandaj duhet të vendosin se si ti shpenzojnë fondet.
- **Fokusi në prioritetet:** Ne besojmë se mbështetja organizative u ofron organizatave më shumë kontroll mbi mënyrën e kanalizimit të fondeve, duke siguruar që fondet të ndahen për prioritetet dhe në rajonet gjeografike që shpesh anashkalohen nga donatorët.
- **Qëndrueshmëria dhe ngritja e kapaciteteve:** Mbështetja organizative u mundëson organizatave të ngrisin kapacitetet e tyre të brendshme organizative dhe të stafit të tyre. Kjo mënyrë e mbështetjes u mundëson dhe të arrijnë më shumë ndryshime afatgjata në komunitetet e tyre sesa aktivitetet *ad hoc*. Gjithashtu u mundëson ti përditësojnë sistemet e tyre organizative për të ardhmen, për qëndrueshmëri më afatgjatë.
- **Fleksibiliteti:** Mbështetja organizative u siguron organizatave anëtare fleksibilitetin për të ndjekur prioritetet e tyre dhe zvogëlon ngarkesën e punës administrative lidhur me kërkesat specifike të donatorëve lidhur me zbatimin e projekteve. Mbështetja organizative mund ti përshtatet ndryshimit të prioritetëve në terren në përputhje me rrethanat, të tilla si ndryshimet e grupeve të synuara, fushëveprimit, shëndetit dhe/ose rrethanat politike.
- **Pavarësia:** Mbështetja organizative u mundëson organizatave të zbatojnë strategjitë në mënyrë të pavarur dhe të jenë më pak të nxitura nga donatorët.
- **Ndikimi më i gjerë:** Hulumtimi ynë tregon se mbështetja organizative u lejon organizatave të shoqërisë civile të grave të përqendrohen më shumë në ndikim sesa në mbijetesë. Mbështetja organizative kursen kohën e aktivisteve për kërkim të fondeve dhe raportim, kohë të cilën mund ta përdorin drejt arritjes së ndryshimeve afatgjata në shoqëri.

Shpenzimet e papranueshme

Duke pasur parasysh kërkesat nga donatorët e RrGK-së, mbështetja organizative nuk duhet të përdoret për blerjen e pronës, tokave ose ndërtesave. Blerja e pajisjeve mund të bëhet vetëm me aprovim nga RrGK dhe me kusht që ky të mos jetë qëllimi kryesor i veprimit që ju parashihni në aplikacion. Në këtë rast mënyra se si pajisjet do të përdoren dhe asgjësohen pas përfundimit të kontratës duhet të dokumentohet. Granti nuk mund të përdoret për: borxhet dhe tarifat e lidhura me shërbim; provizionet për humbjet; detyrimet e mundshme në të ardhmen; provizionet; kostot e udhëtimit për biletat të aeroplanit të klasit të biznesit ose klasit të parë; kreditë për palët e treta; mëditje shtesë, të tilla si mëditje për pjesëmarrje në takime apo mëditjet për stafin pjesëmarrës/folësit në punëtori; dhe për pjesëmarrje ose mbështetjen e partive, grupeve, lëvizjeve ose fushatave politike.

NDARJA E GRANTEVE

Grantet të cilat do të ndahen në këtë raund do të marrin mbështetje nga iniciativat e RrGK financuar nga këta donatorë:

- Trusti Sigrid Rausing në vlerë të paktën 58,000€;
- Fondacioni Kvinna till Kvinna në vlerë prej 20,000€;

² Kjo pjesë është nxjerrë nga raporti i RrGK -së për "Ku janë paratë për të drejtat e grave" dhe raporti i ICAN 2020 "Financimi i Grave Ndërtuese të paqes: Çmontimi i barrierave për paqen"

Shuma totale që pritet të shpërndahet gjatë këtij raundi është të paktën 78,000€.

MADHËSIA DHE KOHËZGJATJA E GRANTEVE

RrGK parasheh të ndaj të paktën tetë (8) grante në vlerë maksimale prej 10,000€ secili. Iniciativat pritet të fillojnë rreth 15 nëntori 2021 dhe nga momenti i nënshkrimit të kontratës mund të zgjasin maksimalisht deri në shtatë (7) muaj, për të përfunduar jo më vonë se 15 gershor 2022. RrGK rezervon të drejtën të financojë disa apo asnjë nga aplikacionet e paraqitura, si dhe t'i diskutoj me organizatat aplikuese alokimin e aktiviteteve sipas nevojës duke mos dalë jashtë kategorive të lartpërmendura. Vendimi final do të merret nga Komisioni për Vlerësimin e Granteve (KVG) i FGK-së, i cili është përzgjedhur nga organizatat anëtares të RrGK.

KUSHTET E PËRZGJEDHJES

Organizatat që aplikojnë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

1. Të jenë anëtare zyrtare të RrGK-së;
2. Të jenë të fokusuara në fuqizimin e grave dhe/ose në avancimin e barazisë gjinore;
3. Të kenë të ardhura vjetore totale organizative prej më pak se 20,000€ në vit;
4. Të mos kenë anëtare të stafit që janë aktualisht pjesë e bordit të RrGK-së, ose KVG-së.

KVG do t'i japë përparësi financimit organizatave që:

- Kanë një strategji të artikuluar qartë ose qëllime strategjike si organizatë, në drejtim të fuqizimit të grave dhe/ose avancimit të barazisë gjinore në Kosovë, nëse nuk kenë një strategji të shkruar, në formën për aplikim mund të shkruani me pak fjali qëllimet strategjike;
- Kërkojnë të sjellin ndryshime afatgjata në përkrahjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në nivel lokal dhe/ose qendror (p.sh. organizatat që synojnë të kontribuojnë në rezultate të prekshme dhe të dukshme si: në legjislacione të reja, përmirësimin e shërbimeve shtetërore për gratë, për buxhetet komunale më të përgjegjshme ndaj nevojave të ndryshme të grave, etj.);
- Kanë synime strategjike që do të kontribuojnë në zbatimin e [Strategjisë së RrGK-së për vitet 2019-2022](#), e krijuar nga anëtarët e RrGK për të adresuar së bashku pabarazitë kryesore gjinore që ato i identifikuan në Kosovë;
- Shpjegojnë mirë në aplikacionin e tyre se si mbështetja organizative do t'u mundësojë atyre të arrijnë qëllimet strategjike të organizatës së tyre;
- Kanë një anëtarësi të qartë dhe/ose përfituesit të cilës i shërben organizata;
- Raportojnë rregullisht tek përfituesit, anëtarësia dhe/ose bordi i tyre në lidhje me arritjet drejt realizimit të qëllimeve të tyre strategjike, siç është e paraparë në statutin e tyre;
- Kërkojnë në mënyrë aktive përfshirjen e grave dhe vajzave të ndryshme, duke mbështetur dhe/ose përfshirë persona me aftësi të ndryshme, grupe etnike të minoriteteve, nga vendet rurale, të rinjtë dhe/ose personat e marginalizuar në punën e tyre;
- Paraqesin një buxhet të plotë organizativ për vitin 2021 dhe 2022 bazuar në financimin e siguruar dhe financimin e kërkuar; aplikacioni duhet të shpjegojë qartë mënyrën se si përdorimi i fondeve do të mbështesë buxhetin e përgjithshëm të organizatës *[Ju lutemi vini re: buxheti organizativ është një buxhet që përfshin të gjitha shpenzimet ekzistuese dhe të parashikuara të organizatës për të gjithë stafin, veprimet dhe aktivitetet e planifikuara për atë periudhë, drejt arritjes së qëllimeve të saj strategjike]*. Në buxhet

duhet të paraqiten kolonat që tregojnë fondet që organizata ka siguruar, fondet që pret, dhe fondet që duhet siguruar për realizimin e qëllimeve të tyre për atë vit. Stafi i RrGK është i gatshëm të ofroj përkrahje anëtarëve në përgatitjen e këtij dokumenti, në rast nevojë;

- Dëshmojnë se si e monitorojnë dhe vlerësojnë punën e tyre dhe si planifikojnë ta bëjnë këtë në të ardhmen;
- U mungojnë mundësi tjera të sigurimit të fondeve nga donatorë të ndryshëm; dhe
- Dëshmojnë përvojë në zbatimin e suksesshëm të grantit të mbështetur nga FGK në të kaluarën.

PROCEDURAT E APLIKIMIT

Aplikacionet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Aplikacioni i plotë duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike në e-mail adresën: grants@womensnetwork.org. Aplikuesit duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

1. **Aplikacionin**, duke përdorur formën e aplikimit të RrGK-së (në formatin Word, i bashkëngjitur dhe në dispozicion në: www.womensnetwork.org);
2. **Strategjinë e organizatës**, dokumentin e plotë, apo një përshkrim të shkurtër të qëllimeve strategjike të organizatës;
3. **Statutin**; dhe
4. **Buxhetin e përgjithshëm organizativ për vitin 2021 dhe 2022**, duke përdorur formën e RrGK-së ose formën e organizatës suaj. (në formatin Excel, të bashkëngjitur dhe në dispozicion në: www.womensnetwork.org);

Propozimet e paraqitura RrGK-së duhet të jenë punë origjinale që i përkasin vetëm organizatës aplikuese. Plagjiatura do të rezultojë në diskualifikimin nga procesi i vlerësimit të mëtutjeshëm.

RrGK do të mbajë të gjitha materialet dhe dokumentet e dorëzuara nga aplikantët. RrGK nuk do të përdorë informacionin e paraqitur nga aplikantët për qëllime të tjera, përveç shqyrtimit dhe nuk do të ofrojë këtë informacion për persona të tjerë apo institucione, përveç kur kërkohet nga ligjet e Kosovës ose nga donatorët.

Pas dorëzimit të aplikacioneve, organizatat aplikuese do të marrin një letër konfirmimi të pranimit me një numër të aplikimit, të nënshkruar nga stafi i RrGK-së.

VLERËSIMI I APLIKACIONEVE

KVG do të vlerësojë aplikacionet sipas kriterëve të mëposhtme.

Kriteret	Pikët
Keni një strategji ose qëllimet strategjike të organizatës të artikuluar qartë	10
Kërkoni të sjellni ndryshime afatgjata në përkrahjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në nivel lokal dhe/ose qendror.	10
Keni synime strategjike që do të kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë së RrGK-së për vitet 2019-2022.	5
Keni shpjeguar mirë se si mbështetja organizative do t'u mundësojë ti arrini qëllimet strategjike të organizatës.	10
Keni anëtarësi të qartë dhe të raportoni rregullisht tek përfituesit, anëtarësia dhe/ose bordi juaj në lidhje me arritjet drejt realizimit të qëllimeve tuaja strategjike, siç është e paraparë në statut	10

Kërkoni në mënyrë aktive gjithëpërfshirjen e grave dhe vajzave të ndryshme, duke mbështetur dhe/apo angazhuar persona me aftësi të ndryshme (2.5), grupe etnike minoritare (2.5), të rinj (2.5), nga vendet rurale (5) dhe/apo persona të marginalizuar në punën tuaj (2.5).	15
Keni paraqitur një buxhet të plotë organizativ për vitin 2021 dhe 2022.	10
Keni dëshmuar se si e monitoroni dhe vlerësoni punën tuaj dhe si planifikoni ta bëni këtë në të ardhmen.	5
Keni mungesë të mundësive të sigurimit të fondeve nga donatorë të ndryshëm.	20
Keni dëshmuar përvojën në zbatimin e suksesshëm të grantit të mbështetur nga FGK në të kaluarën.	5
Gjithsej	100

AFATET KOHORE TË PARASHIKUARA

Aktiviteti	Data
Publikim i thirrjes për aplikim	6 shtator 2021
Sesioni informues	6 shtator 2021
Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	4 tetor 2021
Data kur pritët publikimi i aplikacioneve të përzgjedhura	12 nëntor 2021
Sesioni Orientues, nënshkrimi i kontratave, dhe data kur pritët fillimi i projekteve	15 nëntor 2021